



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të neneve 13.7,14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe të neneve 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, të dt. 3. 7. 2003, të shpallur sipas Rregullorës nr. 2003/30, të dt.10.9.2003; të nenit 3, par.1, pika “b”, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45, dt.11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b dhe nenit 40, par.3, pika II të Statutit të Komunës së Prishtinës, dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2007, merr

## **V E N D I M**

### **PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES PËR LAGJEN “SOFALIA”**

#### **Neni 1**

Fillon hartimi i Planit rregullues për lagjen “Sofalia” në Prishtinë.

#### **Neni 2**

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik- zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

#### **Neni 3**

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar si lagja “Sofalia”, e cila kufizohet me unazën e brendshme, përgjatë rr.“Isa Kastrati” duke u kufizuar me lagjen “Tauk-Bahçe” (Velania), përgjatë rrugës “1 Tetori”, duke vazhduar rrugës “Nazim Gafurri” dhe duke u kufizuar me Planin detal të lagjes “Taslixhe” dhe lagjes “Vreshtat” deri te unaza e brendshme, në një sipërfaqe prej 250 ha. Karakterizohet me pozitën e saj në verilindje të qytetit, e tanguar me unazën e brendshme dhe parkun “Gërmia”, si dhe me përmbajtjet e saja ekzistuese kryesisht për banim etj.. Kufijtë e përshkruar të hapsirës, nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Bartësi i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit.

#### **Neni 5**

Mjetet financiare plotësuese për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

### **Neni 6**

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në mënyrë që ai t`i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtoritë e Komunës së Prishtinës janë të obliguara që t`i sigurojnë dhe t`ia dërgojnë shënimet për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendim, Drejtoratit të Planifikimit, Urbanizmit dhe të Ndërtimtarisë.

### **Neni 8**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.Nr. 35-134, më 29.03.2007**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**

## **ARSYETIM I VENDIMIT PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES “SOFALIA”-PRISHTINË**

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës mbi miratimin e detyrave vijuese pas miratimit të Planit strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, ku janë caktuar prioritetet e hartimit të planeve rregulluese, përfshihet edhe plani rregullues për lagjen “Sofalia”.

### ***POZITA DHE GJENDJA EKZISTUESE E LAGJES***

Hapësira që përfshihet me planin rregullues të lagjes “Sofalia”, përkufizohet me Unazën e brendshme, përgjatë rrugës “Isa Kastrati”, duke u kufizuar me lagjen “Tauk-Bahçe” (Velania), përgjatë rrugës “1 Tetori”, rr. “Nazim Gafurri” dhe duke u kufizuar me hapësirën e planit detal të lagjes “Taslixhe” dhe lagjes “Vreshtat” deri te Unaza e brendshme. Kjo hapësirë përfshinë një sipërfaqe prej 250 hektarësh, e cila karakterizohet me pozitën e saj në verilindje të qytetit, e tanguar me Unazën e brendshme dhe me parkun e Gërmisë, si dhe me përmbajtjet e saja ekzistuese kryesisht për banim dhe të tjera.

Konfiguracioni i terrenit të kësaj lagjeje është me rënie të konsiderueshme dhe mjaft atraktive.

Sipas Planit strategjik - zhvillimi urban i Prishtinës, hapësira që përfshihet në këtë plan është e definuar si zonë mikste urbane për biznes dhe banim të dendur dhe si zonë kryesisht për banim.

Në kuadër të kësaj hapësire gjendet një numër i konsiderueshëm i objekteve të ndërtuara pa leje, të destinuara për banim, të ndërtuara pa kriteret urbane dhe pa infrastrukturë adekuate.

Me këtë plan synohet të planifikohet kjo hapësirë dhe të krijohen mundësi për ndërtim legal dhe me normativa urbane.

**DREJTORATI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT DHE I NDËRTIMTARISË  
I KOMUNËS SË PRISHTINËS**